

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Protestë masive në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, djemtë e liderëve të UÇK: Nuk dorëzohemi, politikanët të bëhen bashkë
ADRESA	https://versus.al/live-updates/proteste-masive-ne-prishtine-kunder-vendimit-te-hages-dje-mte-e-lide-i46753
BURIMI	versus.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 11:26:15 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 11:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	72e303c860b263ea85fc43c5c0f22c35028dbf36d96e48d62b4341c09c37ac0f
TEKSTI	0b324d1c22a82b6afb6e6f91005e9e690651bca68e5dbb50bf71845fcc3e1af5
PAMJA	9b365261e1d428b8e8c95b2ddbe57d4bd0ca441c5fc53e7526484a3d64fa2951

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3f12837bba0b3c162cfd7c8cf9be53728c64ec9d18679392f825ce5275e594d7
E MËPARSHMJA	60f29fb042dc20633fcf88b61f41c814073c72ab43d0b0ffd494918ae67c8f14
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3f12837bba0b3c162cfd7c8cf9be53728c64ec9d18679392f825ce5275e594d7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

Protestë masive në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, djemtë e liderëve të UÇK: Nuk dorëzohemi, politikanët të bëhen bashkë

18 Shtator 2026, 13:00

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[Live Updates](#) / 18 Shtator 2026, 13:00

Protestë masive në Prishtinë kundër vendimit të Hagës, djemtë e liderëve të UÇK: Nuk dorëzohemi, politikanët të bëhen bashkë

*Mijëra shqiptarë protestuan sot në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë kundër vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës për 4 liderët e UÇK-së të cilët u dënuan me 81 vite burg në total për krime lufte. *Në protestë morën pjesë edhe krerë të forcave politike opozitare të cilët u shprehën të gatshëm për çdo nismë që mund të ndërmerret për t'u ardhur në ndihmë liderëve të UÇK. *Djemtë e katërshes së dënuar thanë se nuk duhej të dorëzoheshin dhe se të gjitha partitë politike duhet të ishin të bashkuara për këtë kauzë.

Çfarë do të gjeni në brendësi

*Mijëra shqiptarë protestuan sot në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë kundër vendimit të Gjykatës Speciale të Hagës për 4 liderët e UÇK-së të cilët u dënuan me 81 vite burg në total për krime lufte. *Në protestë morën pjesë edhe krerë të forcave politike opozitare të cilët u shprehën të gatshëm për çdo nismë që mund të ndërmerret për t'u ardhur në ndihmë liderëve të UÇK. *Djemtë e katërshes së dënuar thanë se nuk duhej të dorëzoheshin dhe se të gjitha partitë politike duhet të ishin të bashkuara për këtë kauzë.

3 Postime

38 MINUTA ME PARE

I ati u dënua me 18 vite burg, djali i Kadri Veselit: Nuk e kemi humbur besimin tek drejtësia e Perëndimit



Klestori Veseli, djali i Kadri Veselit, foli për mediat pas përfundimit të protestës në Prishtinë, e cila u mbajt në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së. I riu tha se familjet e liderëve të UÇK-së nuk e kanë humbur besimin tek drejtësia e botës perëndimore.

"Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore, tek drejtësia e tyre. Ne vetëm po kërkojmë korrigjim të një gabimi që ka qenë i zhytur në politikë. Faleminderit edhe juve që po i kushtoni vëmendje kësaj pune", tha Veseli i cili u pa mes protestuesve, por nuk mori fjalën në podiumin e vendosur. [Versus.al](#)

1 ORE ME PARE

"Nuk duhet të dorëzohemi", djali i Jakup Krasniqit: Vendimi i Hagës prek sakrificën e çdo dëshmori





Altin Krasniqi, djali i Jakup Krasniqit i cili u dënua me 25 vite burg, foli para qytetarëve në protestën e sotme në sheshin "Skënderbeu" ku bëri thirrje që askush të mos dorëzohej.

Ai tha se vendimi i Hagës prek sakrificën e bërë nga dëshmorët dhe veteranët, ndërsa u kërkoi partive politike të bëheshin bashkë në këtë kauzë.

"Sot jam jo vetëm si biri i njeriut që po i bëhet padrejtësi, por si biri i këtij populli. Ajo që ndodhi në Hagë, prek sakrificën e çdo dëshmori, çdo veterani, çdo të zhdukuri familjet e të cilëve ende e kërkojnë. Sot nuk duhet të dorëzohemi sepse nëse ne dorëzohemi do të na gjykojë jo vetëm historia por edhe e ardhmja. Për 6 vjet kemi kërkuar drejtësi dhe do vazhdojmë të kërkojmë drejtësi. Sot i bëjmë thirrje edhe të gjithë partive politike të lëmë anash të gjitha dallimet dhe le të bëhemi bashkë", tha Altin Krasniqi. **Versus.al**



1 ORE ME PARE

Sot protestë në Prishtinë kundër dënimit të liderëve të UÇK, shfaqet edhe Ramush Haradinaj





Sot në orën 12:00 shqiptarët e Kosovës kanë paralajmëruar një protestë kombëtare në sheshin "Skënderbej" në Prishtinë për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës Speciale për dënimin me 81 vite burg të 4 liderëve të UÇK.

Ndërsa numri i protestuesve po shtohet me flamuj kombëtarë e pankarta në duar, në shesh mbërriti edhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj së bashku me deputetët e partisë AAK.

Ai më herët u kishte bërë thirrje qytetarëve për të shmangur trazirat. **Versus.al**

Tags:

[hashim thaci](#) [kadri veseli](#) [jakup krasniqi](#) [rexhep selimi](#)

Poll



Live Updates

[PS miraton me 84 vota pr/ligjin, pagat e gjyqtarëve rriten sa 2% e rrogës së presidentit! PD: Puç kushtetues](#)

18 Shtator 2026, 10:00

^ekstrakti^



Live Updates

[Kuvend dhe protestë, parlamenti i Shqipërisë dënon vendimin e Hagës: Liderët e UÇK luftuan për liri](#)

17 Shtator 2026, 12:10

^ekstrakti^



Live Updates

[Dënimi i liderëve të UÇK si 'rrufe në qiell të hapur'! Trazira në Kosovë, shqiptarët rrethojnë godinën e EULEX](#)

16 Shtator 2026, 14:17

^ekstrakti^



Live Updates

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.